



## Platforma e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemin bankar

Banka e Shqipërisë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Shoqata Shqiptare e Bankave

## Hyrje

Banka e Shqipërisë në cilësinë e institucionit rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit bankar, Agjencia e Sigurimit të Depozitave në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin e skemës së sigurimit të depozitave, si edhe Shoqata Shqiptare e Bankave janë dakord që sigurimi i mbajtjes së saktë dhe ruajtjes së të dhënave të depozituesve nga bankat anëtare të skemës është një element kyç për t'iu mundësuar depozituesve akses të shpejtë në depozitat e tyre, në rast të një ngjarje sigurimi.

Agjencia, ka vlerësuar vazhdimisht se treguesi i cilësisë së të dhënave të depozituesve është thelbësor për të përmbushur mandatin ligjor të saj në rast të një ngjarje sigurimi. Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka kjo çështje, Agjencia në verifikimet periodike në të gjithë bankat ka kontrolluar mbarëvajtjen e këtyre të dhënave, si dhe ka nxitur me rekomandime përditësimin dhe përmirësimin e të dhënave të depozituesve. Një rëndësi të veçantë në këto rekomandime ka patur standardizimi i fushave të caktuara me të dhënat e depozituesve, duke veçuar këtu standardizimin e fushës së numrit personal/NUIS-it në dokumentin e identifikimit shqiptar, standardizimin e fushës së numrit të dokumentit të identifikimit, etj. Një rekomandim tjetër në raportet e verifikimit ka qenë dhe kontrolli nga ana e bankave, i dosjeve fizike të depozituesve dhe pasurimi dhe përmirësimi i të dhënave në sistemet elektronike të bankave, më të dhënat e këtyre dosjeve. I rëndësishëm ka qenë dhe bllokimi i veprimeve në degët e bankës për të gjithë depozituesit që kanë probleme me të dhënat e tyre në sistem, deri në momentin e paraqitjes së tyre në bankë dhe përditësimin dhe plotësimin të këtyre të dhënave.

Gjithashtu, Agjencia në të gjitha trajnimet e saj me subjektet e siguruar, ka trajtuar si një çështje të rëndësishme të parë, trajnimin e stafit që punon me klientët në lidhje me hedhjen e saktë të të dhënave të depozituesve dhe depozitave në sistemet e bankave dhe shkk-ve, si dhe përditësimin e këtyre të dhënave me paraqitjen e klientëve në bankë.

Pavarësisht se ka patur përmirësim në disa kategori të të dhënave të depozituesve në banka, Agjencia në vijueshmëri ka adresuar problemin e mungesës së numrit personal/NUIS-it në këto të dhëna dhe ka bashkëpunuar intensivisht me bankat anëtare të skemës, të cilat nga ana e tyre kanë detyrimin ligjor për mbajtjen, ruajtjen, si dhe raportimin e të dhënave të depozituesve dhe depozitave, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi.

Agjencia gjatë vitit 2019, me asistencën e ekspertëve të FSVC, kreu procesin e “Vlerësimit të përputhshmërisë së Skemës së Sigurimit të Depozitave me Parimet bazë për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI)”. Ekspertët në vijim të dërgimit të raportit përfundimtar, mbështetur në parimin bazë 15: “Kompensimi i depozituesve”, konkretisht lidhur me Kriterin bazë 4: “Për t’iu siguruar depozituesve akses të shpejtë në fondet e tyre”, kanë rekomanduar:

“Nisur nga çështjet e identifikuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në lidhje me paraqitjen unike të depozituesve, rekomandohet një bashkëpunim më i ngushtë midis ASD-së dhe BSh-së, për përmirësimin e të dhënave të depozituesve në përputhje me kërkesat për raportimin e listëpagesës me paraqitjen unike të depozituesve”<sup>1</sup>.

“ASD-ja duhet të punojë ngushtë me autoritetet për të detyruar marrjen e masave ligjore në lidhje me procesin e krijimit të listës me Paraqitjen Unike të Depozituesve, në mënyrë që çdo problem operacional të identifikohet dhe të adresohet saktë. Për një përmirësim të mëtejshëm të të dhënave të depozituesve, është e këshillueshme që BSh-ja dhe ASD-ja të kenë një marrëveshje formale për këtë qëllim<sup>2</sup>.”

Platforma e përmirësimit të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave, i shërben objektivit kryesor të Agjencisë për kryerjen e saktë dhe të shpejtë të një procesi kompensimi, si dhe njëkohësisht konvergjon me kërkesat ligjore të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të sistemit financiar, në veçanti në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Iniciativa “Platforma e përmirësimit të cilësisë së të dhënave për depozitat dhe depozituesit në sistemin bankar”, synon të nxisë përmirësimin e cilësisë së të dhënave duke vendosur veprime dhe afate të detyrueshme për zbatim nga bankat anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, moszbatimi i të cilave do të jetë subjekt i masave parandaluese si dhe sanksioneve në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

Në takimet dhe konsultimet e zhvilluara gjatë fazës së parë të përgatitjes së kësaj platforme me të gjitha bankat anëtare, Agjencia adresoi problematikat e evidentuara ndër vite, në lidhje me cilësinë e të dhënave të depozituesve dhe depozitave dhe kërkoi që secila nga bankat të propozonte planin individual të veprimeve për zgjidhjen e tyre. Pas prezantimit në Agjenci të planeve individuale nga secila bankë, në fazën e dytë, Agjencia hartoi planin e përgjithshëm të veprimeve, në të cilin u përfshinë propozimet nga vetë bankat, si dhe rekomandimet e propozuara nga Agjencia, bazuar në proceset e verifikimeve të kryera. Në vijim platforma u konsultua dhe u dakortësua me Bankën e Shqipërisë, si dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave. Në fazën e tretë, e cila konsiston në zbatimin dhe monitorimin e veprimeve të propozuara në këtë platformë, Agjencia do të vijojë të bashkëpunojë ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave, nëpërmjet monitorimit të zbatimit të saj. Për këtë qëllim, Agjencia do të verifikojë zbatimin dhe do të informojë në mënyrë periodike Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave.

Ecuria e zbatimit të platformës, do të jetë pjesë e raportimeve tremujore që bankat paraqesin pranë Agjencisë, me përjashtim të rasteve kur këto afate nuk përputhen me këto raportime. Platforma mund të rishikohet, në varësi të ecurisë së procesit për përmirësimin e cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave.

---

<sup>1</sup> “Given the issues identified by ADIA related to SCV, closer cooperation between ADIA and BOA is recommended to improve depositor data in accordance with SCV requirements.”

<sup>2</sup> “ADIA must work closely with authorities to enforce the legal provisions on the Single Customer View (SCV) process so that any operational constraints are identified and addressed. To further improve the accuracy of the data of depositors, it is advisable that BOA and ADIA have a formal arrangement for this purpose.”

## Platforma e përmirësimit të cilësisë së të dhënave për depozitat dhe depozituesit në sistemin bankar

Nr.	Veprimi	Komente	Afati
1.	Kontrolli i të gjithë dosjeve të depozituesve.	Nga verifikimet është konstatuar që ka ende të dhëna të depozituesve që disponohen në dosjet fizike të tyre, të cilat nuk janë pasqyruar në sistemet e bankave. Kontrolli i dosjeve fizike dhe plotësimi i të dhënave në sistem, do të përmirësojë numrin e depozituesve me të dhëna të sakta.	Dhjetor 2021
2.	Standardizimi i fushave me të dhënat e depozituesve: 2.1. Kontrolli automatik për plotësimin e saktë të fushës së: a. Numrit personal b. Numrit serial të dokumentit të identifikimit c. Datës së skadencës së dokumentit të identifikimit	Evidentohet fakti që mjaft prej bankave kanë bërë ndryshimet e duhura në lidhje me standardizimin e fushave, për të zvogëluar probabilitetin e mosplotësimit saktë të këtyre të dhënave. Por gjithsesi, standardizimi i këtyre fushave nga të gjitha bankat, vendosja e kontrolleve automatike, si dhe bllokimi i veprimeve të mëtejshme pa plotësuar këto fusha, do të rrisë numrin e depozituesve me të dhëna të plota dhe të sakta.	Qershor 2021
2.2.	Plotësimi me kodin <i>iso</i> të fushës së shtetësisë, në përputhje me shtetin që lëshon dokumentin e identifikimit.	Është konstatuar që një numër i konsiderueshëm depozituesish që nuk kanë dokument identifikimi të lëshuar nga shteti shqiptar, në verifikimet e kryera rezultojnë të rrisin në mënyrë artificiale numrin e depozituesve me mungesa/pasaktësi në të dhënat e tyre identifikuese. Plotësimi me kodin <i>iso</i> të fushës së shtetësisë, në përputhje me shtetin që lëshon dokumentin e identifikimit, do të ndikojë në rritjen e numrit të depozituesve me të dhëna të plota dhe të sakta.	Qershor 2021
2.3.	Standardizimi i adresës së depozituesve si më poshtë: a. Linja e parë – rruga/lagjja, nr. i ndërtesës, nr. i apartamentit b. Linja e dytë – Njësia administrative/fshati/rajoni c. Linja e tretë – Kodi i shtetit/qyteti	Nga verifikimet janë konstatuar mangësi në plotësimin e fushës për të dhënat e adresës së depozituesit, p.sh. në mjaft raste është plotësuar vetëm qyteti. Për këtë qëllim kërkohet që sistemi i bankave të mundësojë standardizimin për plotësimin e të dhënave të adresës së depozituesit.	Dhjetor 2021
3.	Bllokimi i veprimeve në degët e bankës për të gjithë depozituesit që kanë probleme me të dhënat e tyre në sistem (pasi janë njoftuar më parë), deri në momentin e paraqitjes së tyre në bankë dhe përditësimit dhe plotësimit të këtyre të dhënave.	Shumica e bankave kanë të vendosur bllokimin e veprimeve për depozituesit me probleme në të dhënat e tyre, në mënyrë që në momentin që paraqiten në bankë, punonjësi i shërbimit me klientët të ketë kujtesë për të plotësuar/përditësuar të dhënat, e më pas për të vijuar me veprimet. Zbatimi nga të gjitha bankat i bllokimit të veprimeve në degë, do të mundësojë përditësimin e të dhënave të depozituesve.	Mars 2021

4.	Rinovimi/bllokimi brenda një periudhe (p.sh. tremujore) i kartave të debitit për depozituesit që kanë mungesa në të dhënat e tyre personale.	Për të gjithë depozituesit që kanë një kartë debiti, por kanë mungesa në të dhënat e tyre personale, rinovimi i kartave të debitit para afatit të printuar në kartë do të mundësonte paraqitjen e tyre në degët e bankës, përditësimin dhe plotësimin e të dhënave të munguara.	Dhjetor 2021
5.	Eliminimi i dublikimit të klientëve në procesin e rihapjes së llogarive të depozituesve ekzistues me të dhëna të ndryshuara/të tjera, në rastet kur janë mbyllur më parë.	Janë konstatuar raste që klientë ekzistues me llogari/depozitë të mbyllur, paraqiten në bankë dhe rihapin llogari/depozitë, pasi mund të kenë ndryshuar disa nga të dhënat e tyre identifikuese. Rihapja e llogarisë/depozitës bëhet gabimisht si për një klient të ri.	Dhjetor 2021
6.	Krijimi i Arkivës elektronike për të dhënat e depozituesve dhe depozitave.	Hapja dhe përdorimi i arkivës elektronike për hedhjen dhe ruajtjen e të dhënave të depozitave dhe depozituesve, do të përmirësonte punën për mirëmbajtjen e saktë të të dhënave të depozituesve.	Qershor 2022
7.	Përfshirja në treguesit e vlerësimit të punës, për punonjësit e shërbimit të klientelës, të treguesve të cilësisë së të dhënave të depozituesve dhe depozitave.	Nga eksperiencia e disa bankave, është vërtetuar që lidhja e treguesit të cilësisë së të dhënave të depozituesve, me treguesit e performancës së punonjësve të degëve të bankave, ka dhënë rezultate në përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave të depozituesve.	Dhjetor 2021
8.	Treguesi i mungesës së <b>numrit personal/NUIS-it</b> në sistemin e bankës, për depozituesit, duhet të jetë zero.	Fusha e numrit personal/NUIS-it është një fushë e cila mbas datës së miratimit të platformës duhet të jetë patjetër e plotësuar, për të gjithë depozituesit klientë të rinj të bankës.	Raportim çdo tre muaj
9.	Treguesi i pasaktësisë (hedhur me gabime në sistemin e bankës) së <b>numrit personal/NUIS-it</b> të depozituesit nuk duhet të jetë me shumë se 0.01% në tremujor.	Gabimet operacionale të plotësimit të kësaj fushe mund të lejohen deri në limitin e përcaktuar menjëherë mbas datës së miratimit të platformës.	Raportim çdo tre muaj
10.	Treguesi i përmirësimit të të dhënave për depozituesit aktivë, duhet të jetë jo më pak se 4% <sup>3</sup> për çdo tremujor.	Mungesat dhe gabimet operacionale për depozituesit aktivë, duhet të përmirësohen me ritme më të shpejta, se sa për depozituesit jo aktivë.	Raportim çdo tre muaj
11.	Treguesi i përmirësimit të të dhënave për depozituesit jo aktivë, duhet të jetë jo më pak se 2% <sup>4</sup> për çdo tremujor.	Bankat përveç masave të marra për parandalimin e gabimeve operacionale në plotësimin e të dhënave të depozituesve dhe depozitave të reja, do të vijojnë punën për plotësimin dhe përmirësimin e të dhënave të depozituesve jo aktivë.	Raportim çdo tre muaj

Banka e Shqipërisë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Shoqata Shqiptare e Bankave

Natasha Ahmetaj

Genci Mamani

Silvio Pedrazzi

Zv. Guvernator e dytë

Drejtor i Përgjithshëm

Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave

<sup>3</sup> Me kontaktimin e klientit, realizohet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të depozituesve, për të gjithë treguesit që raportohen në Agjenci. Për rrjedhojë përmirësimi kryhet dhe raportohet për secilin nga zërat e kërkuar në raportimet tremujore.

<sup>4</sup> Për shkak të impaktit të pandemisë, realizimi i këtij treguesi do të fillojë të raportohet i plotësuar në këtë përqindje nisur nga muaji tetor 2021.